



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T
NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI, TË MBAJTUR MË

27.02. 2015

SHKURT

2015

Mbledhjen e drejton kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Muhamet Mustafa

KRYETARI: Mirë dita të gjithëve,

Fillojë që të propozojë që të fillojmë me këtë dëgjim publik në emër të Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Ju përshëndes të gjithëve,

Ju faleminderit që ju keni përgjigjur ftesës për të marrë pjesë në këtë dëgjim publik i cili ka për qëllim që të mbledhim propozime lidhur me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për ndërmarrjet publike i cili ka kaluar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës dhe tash është në shqyrtim nëpër komisione dhe natyrisht që edhe dëgjimet publike janë një nga format të cilat i përdorë Kuvendi i Kosovës për të marrë imputet prej një rrethi sa më të gjerë akterësh të interesuar në mënyrë që zgjedhjet ligjore dhe normat me të cilat do të përkufizohen çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike në Kosovë të reflektojnë sa më shumë interesat e akterëve të interesuar në rend të parë nga shfrytëzuesit e shërbimeve të ndërmarrjeve publike nga ekspertët, nga forcat politike dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Ne sot sa po u kthjem nga një diskutim shumë cilësor që e kishte organizuar grupi për studime juridike dhe politike. Dhe natyrisht që debatet për këtë ligj dhe për çështjet e “Trepçës” do të vazhdojnë. Ne sot për temë nuk e kemi zhvillimin e mëtutjeshëm të “Trepçës” por kemi normat konkrete të ligjit.

Në këtë mbledhje pra janë ftuar anëtarët e Komisionit që po e shohë që marrin pjesë në përgjithësi. I falënderoj të gjithë duke filluar prej nënkryetarit të Komisionit dhe anëtarëve, zoti Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj, Duda Balje dhe të tjerë.

Përpos kësaj ne kemi ftuar këtu edhe përfaqësues të disa ambasadave, kemi ftuar ekspertë prej shoqërisë civile, përfaqësues të “Trepçës”, asociacionit të komunave, odave ekonomike, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Agjencisë Kosovare të Privatizimit edhe ekspertë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Sa i përket projektligjit, ju sigurisht e keni përcjell debatin i cili është zhvilluar lidhur me këtë projektligj në leximin e parë dhe keni parë se ka qenë një debat mjaftë i angazhuar, mjaftë i gjallë po keni parë se lidhur me disa çështje sa do që kem mund të kenë ndryshime në qasje, ekziston një shkallë e lartë e konsensusit.

Konsensusi lidhur me këtë ligj që është arritur në Kuvend, ekziston në çështjen se ligji është i nevojshëm edhe i rëndësishëm sepse mundëson që ndërmarje të caktuara, setet e tyre apo pronat që tash e kanë karakterin e pronës shoqërore të cilat i administron Agjencia Kosovare e Privatizimit me vendimet e Kuvendit të nxirren nga Administrimi i AKP-së dhe të përdoren për qëllime publike dhe për interesin publik. Ajo që ka zgjuar interes dhe debate të gjera ka qenë çështja e kompetencave të komunave që rregullohet me nenin 3 pikën 11.3 që e keni këtë projektligj. Aty ekziston një konsensus që teksti që është aty nuk e rregullon në mënyrë të nevojshme këtë çështje se ju japë komunave kompetenca që në sistemin tonë kushtetues nuk e kanë. Prandaj, dhe kjo s'ka të bëjë as me ... e një nacionaliteti apo të një rajoni por në përgjithësi. Prandaj, ekziston pajtueshmëria që ky nen duhet të ndryshohet dhe roli i komunave të vije në ato suaza të cilat i lejon Kushtetuta e Kosovës. dhe natyrisht se këtu kemi një konsensus, unë besoj që edhe debati sot mund të na ndihmoj me formulime, domethënë debati i sotëm për atë se ky nen është i keq mendoj se është i deplasumë, këtë e kemi eksplatur. Ky nen do me thënë edhe Qeveria edhe Kuvendi edhe të gjithë janë pajtue që ky nen duhet të riformulohet. Prandaj, kontributi i juaj do të ishte sot se si të formulohet në qoftë se ka ide se si të formulohet.

Çështja tjetër që ka të bëjë me Ligjin e veçantë për “Trepçën” edhe kjo çështje ka konsensus të përgjithshëm edhe ka pajtueshmëri edhe kjo do të adresohet. Është një formulim aty në qoftë se ka një ide për një formulim tjetër janë të mirëseardhura.

Çështje tjera sigurisht mund të ketë në ligj është çështja e falimentimit që disa juristë kanë mendime tjera se nuk është një formulim i duhur. Po sigurisht që ne kemi marrë edhe propozime konkrete prej juristëve.

Para se të bëhet leximi i parë i këtij ligji në Kuvend, unë kam pasur një konsultim me dhjetë juristë të spikatur të Kosovës që i kemi trajtuar të gjitha aspektet lidhur me këtë projektligj.

Unë nuk kish zgjatë më shumë, po kisha hapur diskutimin. Ne nga Komisioni sot jemi këtu që të ju dëgjojmë juve më shumë se sa që të flasim ne sepse nga ajo që do të marrim prej juve mund të na shërbej që t'i riformulojmë sa më mirë nenet e caktuara nëpërmes procesit të amendamentimit të këtij ligji.

Tash unë do ta kisha hapë diskutimin menjëherë lidhur me këtë çështje. Ju lutem që secili që e merr fjalë të prezantohet për arsye se ky diskutim do të transkribohet dhe nevojitet, domethënë që ata që e transkribojnë të cekin edhe emrin e atyre që diskutojnë.

Faleminderit! Po hapi diskutimin.

AGRON DEMI: Faleminderit shumë kryetar!

Përshëndetje për të pranishmit,

Të nderuar deputetë,

Ne kemi marrë ftesën edhe me dëshirë ju kemi përgjigjur sikurse çdo ftese që e marrim prej Komisionit Parlamentar.

E kemi pa planin e punës së Komisionit për këtë dhe e di që Komisioni Parlamentar këtë vit do të fokusohet shumë në ndërmarrjet publike. Andaj një prej rekomandimeve tona është që ky projektligj i cili do të ndryshoj ligjin aktual të mos fokusohet vetëm në këto pika por të përfshijë edhe rekomandime tjera të cilat e përmirësojnë ligjin.

Andaj, një prej rekomandimeve kryesore është që kur të hyjë në fuqi ky plotësim ndryshim bëhen dy ligje plotësim ndryshim një ligji i cili është aprovuar më herët dhe në këtë formë po krijohet një paqartësi ligjore ku duhet me ju referua tri drafteve për të njëjtin ligj. Një prej rekomandimeve që ne i kemi cekur është që do të duhej të kishte një ligj të spastruar i cili pastaj i përfshinë krejt aty se janë ndryshime edhe lexohet e interpretohet shumë më lehtë.

Nuk isha ndal në të gjitha rekomandime për shkak se po besoj që stafi ju ka shpërnda disa komente që i kemi bë nën për nën. Por po ndalna shumë shkurt te neni 11.3 i Ligjit për plotësim ndryshim i cili ka paraqitur edhe paqartësitë apo debatin më të madh.

Neni si është përnime krijon paqartësi edhe konfuzitet. Një prej rekomandimeve tona është që mos të përfshihet si ndërmarrje publike por pronë e cila është pronë shoqërore por jo ndërmarrje publike, për shkak se edhe e dëgjova arsyetimin e ministrit të Financave mbrëmë në një debat. Arsyeja e Qeverisë është pse e kanë përfshirë këtë nen, ka të bëjë me pronën ku shumë komuna kanë mungesë të pronës shoqërore, pronës publike edhe kur i vjen puna me ndërtua një çerdhe apo një shkollë ju bie me pagua shumë më shtrenjtë pronën të cilën e blen prej sektorit privat në vend se të kenë një pronë e cila është vetëm shoqërore.

Për shembull komuna e Fushë Kosovës, tani shumë vjet nuk mundet me ndërtua një çerdhe për shkak se i kushton shumë më shtrenjtë me ble pronën se sa me ndërtua çerdhen. Prandaj, kjo do të duhej të riformulohej që në .. kuptohet vetëm prona po jo ndërmarrja publike në atë komunë.

Neni tjera të cilat kanë të bëjnë të cilat nuk janë të përfshira në projektligjin të cilin po e diskutojmë sot të cilat nuk i kisha përmend shumë për shkak se i keni para vete ka të bëjë me transparencën edhe profesionalizmin e bordeve.

Ne e pamë që javën e kaluar Bordi i PTK-së morri një vendim i cili pikërisht rrjedh prej paqartësive ligjore të cilat janë në Ligjin për ndërmarrjet publike ku i hapë rrugë politizimit, qoftë bordeve qoftë kryeshefave ekzekutiv edhe ne kemi bërë një reagim që Ligji për ndërmarrjet publike do të duhej që të specifikonte që kryeshefat ekzekutiv nuk janë persona politikë. Ashtu siç po interpretohet Ligji për ndërmarrjet publike ku thuhet se përveç kryeshefit ekzekutiv të tjerë nuk duhen të jenë persona politik përveç kryeshefit ekzekutiv. Dhe ne kemi dhënë një rekomandim që kryeshefat ekzekutiv do të duhej të mos ishin të partive politike për shkak se është bërë një dukuri ku vetëm nëse je pjesë e partive politike t'i je kryeshef i mirë ekzekutiv i ndërmarrjeve.

Ne, kryetar kemi pasur një debat më herët ku ju keni qenë prezentë ku i kemi prezantua dy hulumtime tona për gjendjen e ndërmarrjeve publike të cilat i keni para vetes. Prandaj, për mos me marrë më shumë kohë vetëm ju kisha kërkuar që të ju referoheni atyre publikimeve dhe rekomandimeve të sodit.

Edhe një herë faleminderit për ftesën edhe për mundësinë e dhënë për të paraqitur këto kërkesa para jush.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Demi! Do t'i shikojmë me kujdes.

Dëshiroj të ju informoj se Komisioni ka krijuar grupin punues që do t'i marr amendamentet edhe diskutimet që janë bërë dhe transkriptin nga mbledhja e Kuvendit dhe prej të gjitha atyre do t'i propozoj Komisionit amendamentet. Në atë grup jam unë, Visari, Sala Berisha Shala dhe kolegu që sot nuk është prezentë këtu nga Lista Sërpska.

Vazhdojmë me diskutime, urdhëroni!

DARDAN ABAZI: Jam Dardan Abazi, prej institutit INDEP.

Ligji për ndërmarrjet publike i cili sot është objekt ndryshimi pra me këtë projektligj. Ka qenë në qendër të disa aktiviteteve edhe në legjislaturën e kaluar po të këtij Komisioni.

INDEP-i kishte marrë pjesë në të gjitha fazat e monitorimit të zbatimit të Ligjit për ndërmarrje publike. Aktivitet ky i cili ka ndodhë në fund të vitit 2013. Komisioni në atë kohë kishte dal me disa rekomandime mjaftë të rëndësishme për plotësim ndryshimet e këtij ligji.

Duke marrë parasysh një seri aktivitete të cilat i kishte ndërmarrë ky Komision, qoftë dëgjime publike, dëgjime të ndryshme publike me akter të cilët e zbatojnë ligjin qoftë me aktivitete të tjera në terren. Ne jemi të shqetësuar dhe shprehim shqetësimin tonë për shkak se ky projektligj nuk ka marrë për bazë ato rekomandime të cilat kanë dalë nga vet ky Komision.

Sa i përket pakos ligjore të propozuar, fillimisht vërejtja jonë e parë është sa i përket memorandumit shpejtues i cili nuk ka arsyetuar sa duhet politikën e ndërmarrjeve dhe nuk ka sqaruar sa duhet ato të cilat Qeveria ka për qëllim me këtë projektligj. Për shembull në seancën e 12 shkurtit ku projektligji u miratua në lexim të parë, ndër të tjera kryeministri Mustafa deklaroi se ndër qëllimet kryesore të këtij projektligji ishte kalimi i pronave të mbetura shoqërore në pronësi publike me qëllim të shfrytëzimit të tyre për nxitje të investimeve. Ky fakt nuk është shpjeguar sa duhet në memorandumin shpjegues.

Edhe në legjislaturën e kaluar ne vazhdimisht kemi tërhequr vërejtjen për kualitetin e memorandumeve shpjeguese që shpjegojnë propozim aktin ligjor. Praktika e vendeve tjera tregon madje që madje edhe për secilin nen jepet një shpjegim paraprak për arsyeshmërinë e politikës së ndjekur, koston nëse ka dhe rezultatet finale që pritet në vijë nga ai projektligj.

Sa i përket çështjeve të diskutueshme në këtë projektligj, ne konsiderojmë për shembull pjesa që flet për regjistrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe rolin e komunave, konsiderojmë që kjo pjesë e ligjit nuk mund të ketë efekt mbi “Trepçën” për shkak se neni pasues 37a i projektligjit parasheh vazhdimin e gjendjes së tanishme të administrimit të “Trepçës” deri në sjelljen e ligjit të veçantë për të dhe ndalon çfarëdo aktiviteti tjetër përfshirë regjistrimin si ndërmarrje publike bazuar në dispozitat e nenit 3 të projektligjit. Po ashtu sipas këtij ligji “Trepça” do të rregullohet me aktin ligjor.

Sipas parimit juridik “lex specialist derogat lex generalis” kjo do të thotë që norma e veçantë e mbizotëron normën e përgjithshme. Prandaj, ligji i veçantë për “Trepçën” do të përbëjë normë të veçantë ndaj këtij ligji dhe këto dy pika domethënë nuk mund të kenë efekt mbi “Trepçën”. Po që shprehimisht me Ligjin për “Trepçën” thuhet e kundërta.

Ne kemi një propozim tjetër sa i përket komunave që edhe komunat të kenë mundësi të propozojnë që një pjesë e ndërmarrjeve shoqërore ose njësi të tyre të kalojnë në pronësinë e ndonjë ndërmarrje publike lokale, për shkak se kemi pasur rasti ku për shembull disa ndërmarrje publike lokale ju duhen disa prona të ndërmarrjeve shoqërore për të kryer aktivitetet e tyre por nuk mund ta bëjnë. Këtë propozim ne mendojmë që ato duhet ta bëjnë përmes njësisë për monitorim dhe politika si dhe Qeverisë së Kosovës ky propozim do të kalonte për miratim në Kuvend. Duhet theksuar që me rastin e kalimit të ndërmarrjeve shoqërore ose ndonjë pjesë të tyre në ndërmarrje publike borxhet nuk guxon të trashëgohen në pronarin e ri.

Në të kaluarën ka pasur shumë probleme sa i përket rasteve të kalimit të pronësisë nga ndërmarrja qendrore apo rajonale në atë lokale, për shembull Stacioni i Autobusëve në Vushtrri ku AKP-ja kishte bërë pranim dorëzimin e kësaj

ndërmarrje pa njoftuar komunën për borxhet e saj në vlerë prej 4 milionë eurove. Kemi pasur probleme se pastaj komuna nuk e ka pranuar këtë gjë e të tjera.

Instituti INDEP konsideron që rekomandimet e dala nga ky Komision mbi zbatimin e këtij ligji do të duhej pa tjetër të merreshin para sysh në këtë draft të projektligjit. Këto ndryshime kishin të bënin, për shembull me ndryshimin e nenit 29 të Ligjit bazik mbi testimin e knaqshmërisë së konsumatorëve që aktualisht ligji e obligon vetë ndërmarrjen që ta bëjë testimin e knaqshmërisë së konsumatorëve dhe kjo është konsideruar si jo logjike për shkak se duhet një institucion i jashtëm të bëjë vlerësimin e knaqshmërisë së konsumatorëve. Kjo sidomos duke marrë parasysh faktin që objektiv primar i ndërmarrjeve publike është ofrimi i shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve.

Një tjetër gjë e cila është dashtë të adresohet në këtë projektligj do të ishte edhe forcimi i njësisë për politika dhe monitorim. Në atë mënyrë që bordet e ndërmarrjeve publike të cilat nuk kanë përformuar mirë të thirren më tepër në përgjithësi.

Gjithashtu duhet përsëritur që komunave duhet të jetë mundësia e propozimit të kalimit të ndërmarrjeve shoqërore ose një pjesë e tyre ose bashkimit të tyre me ndonjë ndërmarrje publike komunale ekzistuese. Si dhe me rastin e kalimit të këtyre ndërmarrjeve shoqërore në ndërmarrje publike ose lokale pronari i ri nuk mund ta trashëgoj obligimet e saj por ato duhet të mbulohen nga Fondi i AKP-së. faleminderit!

SAZAN IBRAHIMI: Unë jam Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv i asociacioneve të komunave të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj sinqerisht për ftesën që ja keni bërë asociacionit të komunave të Kosovës që do të jetë prezentë në këtë takim.

Ne pas leximit të parë të këtij ligji që është bërë në Parlamentin e Republikës së Kosovës. Drafti është dërguar te ne, e kemi analizuar përmes mekanizmave të asociacionit të komunave të Kosovës dhe kemi konkluduar që ky projektligj nuk e

prek interesat e pushtetit lokal sa i përket themelimit të ndërmarrjeve publike lokale domethënë jemi konsistent në atë që është mirë që Agjencionit Kosovar të Privatizimit të iu pamundësohet shitja e aseteve ku komunat e Republikës së Kosovës kanë interes sidomos për interes publik.

Kemi pasur deri më tani disa insperenca jo të mira të bashkëpunimit të komunave me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, domethënë kanë pasur ndesh në hartimin apo implementimin e politikave të cilat kanë dërguar në interes publik sidomos në ndërtimin e çerdheve, shkollave, ambulanteve e tjera po ndërtesave të cilat janë me interes publik dhe cilat menaxhojnë nga autoritetet lokale.

Kështu që asociacioni i komunave të Kosovës përgëzon iniciativën e Qeverisë së Republikës së Kosovës që komunave të ju epet më shumë autonomi sa i përket menaxhimit të pronës komunale apo në disa raste ndërrimit të pronës komunale me Agjencionin Kosovar të Mirëbesim vetëm për interes publik.

Domethënë në përgjithësi Asociacioni i Komunave të Kosovës e përkrahë projektligjin me disa ndryshime të cilat kanë të bëjnë jo me interesin e autoritete lokale po me interesin nacional. Pra, prej perspektivës tonë gjithçka është në rregull sa i përket interesave të autoriteteve lokale në themelimin e ndërmarrjeve publike lokale. Faleminderit!

AHMET TMAVA: Faleminderit, kryetar!

Jam drejtor i ndërmarrjes shoqërore Trepça nën administrim të AKP-së. Ne ju falënderojmë si Komision Parlamentar, që edhe pse këtu nuk përmendet recidiv si Ligj për ndërmarrje publike, krijohet baza për procedim të mëtutjeshëm dhe hapësirën e sqarimit të statusit, një nga problemet e aktualitetit që me të vërtetë është kah reflekton më shumë dhe me e potencuar edhe një herë, se ndërmarrja me këtë status të paqartë, nuk ka qëndrueshmëri në staza të gjata, merre me mend në këtë kohë ndodhemi pa licencë veprimi edhe mos të përkujtojmë të tjerat edhe krejt këto janë problem i statusit të paqartë sepse, duke qenë një ndërmarrje me karakter shoqëror edhe Ligji për minierat e mineraret ka paraparë kohëzgjatjen e licencës shumë afatshkurtër edhe kjo na ka prurë në një situatë plus elementet tjera ndikuese.

Ne mendojmë që kjo dinamikë po na jap shpresë se më në fund po sqarohet statusi i Trepçës dhe ai status po i jep hapësirë zhvillimore Trepçës në kufijtë dhe në suazat e pritjeve të argumentuara duke ju ikur folklorizmave dhe vlerësimeve nganjëherë që po dalin me kompozitet dhe jashtë reales. Ne mendojmë se Ligji 11 punëson kontributet, 11.3 në aspektin siç është definuar edhe nga kolegët në kuadër të dallimit të pronës dhe ndërmarrjes, duhet të precizohet shumë qartë sepse kemi të bëjmë me një ndërmarrje që nuk është, nuk i takon veç një komune, por shumë komuna dhe nëse fati i një ndërmarrjeje duhet të përcaktohet nga marrëveshjet e shumë komunave, atëherë një komunë që nuk bëhet pjesë e sajna, mund ta pengojë një vizion zhvillimor të caktuar për një ndërmarrje. Prandaj, kjo duhet të precizohet sepse në Ligj për minierat dhe mineralet precizohet fiks edhe tash nuk ka aktivitet minerar pa pëlqim të komunave dhe, nëse definohet veç si pronë në pozicion të destinimit të një prone shoqërore në interes publik, kjo është diçka tjetër, por t'i dallojmë sidomos resurset dhe mundësinë e valorizimit të tyre sepse kjo rregullohet me Ligjin për miniera edhe bijnë ndesh, nuk ka edhe sot aktivitet dhe licencë për një aktivitet minerar pa pëlqim të komunave dhe, nëse e bëjmë edhe këtë, atëherë kjo është një

KRYETARI: pëlqimi i komunave për çka ashtë fjala? ... për me marrë licencë për shfrytëzim, eksploatim të resursi

AHMET TMAVA: Licencën e jap KPMM-ja, por nuk e jep...

KRYETARI: Por në çfarë segmenti....

AHMET TMAVA: Se një nga kushtet për me marrë licencë për me dhënë KPMM-ja licencë një kompanie për një aktivitet minerar, duhet ta sjellë kompania edhe pëlqimin komunal, pëlqimin komunal nëse nuk bie ndesh me planet rregullative, hapësinore, zhvillimore e tjera. Do me thënë është një element ku involvohet komuna, prandaj nëse kemi po them edhe një herë, kjo duhet të qartësohet në atë formë sa që, nëse kemi të bëjmë me nocione ndërmarrje dhe pronë, kjo le të jetë e qartë, por në asnjë mënyrë mendimi im është edhe që nuk mund të involvoj marrëveshje me komuna sepse aktivitetet minerale në këtë rast Trepça nuk është e Mitrovicës, nuk është e Leposaviqit, nuk është e Prishtinës por është e të gjithave sepse resurse minerale kemi në të gjitha komunat.

Pastaj në funksion që thash të startit edhe në propozimin që të rregullohet kjo me një ligj të veçantë aktualiteti dhe situata. Për fat në vitin e kaluar e kemi mbyllur mirë ekspertin ekonomizimit të ndërmarrjes por ky vit na ka filluar shumë keq. Po them edhe një herë mungesa e licencën. Duhet të qiten limite kohore për precizim të Ligjit dhe sqarim të statusit të Trepçës sepse, nëse neglizhohet në aspektin kohor, atëherë do të vijmë deri në një situatë kur Trepça ndoshta do të vjen deri te një situatë e palakueshme që do ta bëjë të turpërohem të gjithë, për fat të keq duke u thirrur edhe na si menaxhment sepse ky muaj ka filluar me telashet që nuk është faji ynë. Nuk kemi licencë qe një muaj dhe sipas të gjitha gjasave, nuk do të kemi më së paku edhe një muaj ditë dhe një afarizëm garantues në aspektin e ekonomizimit, është shumë i vështirësuar. Mirëpo, megjithatë kjo dinamikë dhe angazhim i Komisionit Parlamentar për me e sqaruar statusin, nga na si Trepçë, është për me u falënderuar me shpresë që po ia qesim pikën njëherë mirë sa më shpejtë që është i mundshëm. Faleminderit!

AVNI BYTYQI: Ju faleminderit kryetar!

Të nderuar pjesëmarrës,

Të nderuar deputetë,

Unë jam Avni Bytyqi nga Grupi për studime juridike dhe politike.

Më lejoni që në fillim të them se, edhe pse këtu po folni për çështje që nuk adresohen me këtë propozim ndryshim të Projektligjit për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, vërejtja jonë kryesore është te neni 11.3. Na mendojmë se fjalën “marrëveshje me komunat”, duhet me u ndryshuar, të konsultohet për arsye se marrëveshje është term juridik që nënkupton se dy palë ulen dhe e nënshkruajnë një marrëveshje në bazë të një ligji të caktuar. Kjo nuk rregullohet por vetëm thuhet, pastaj është edhe problemi për arsye se themelimin e ndërmarrjeve publike në nivel lokal është shumë i qartë me ligin aktual, si ato në vend qendror, nuk kemi asnjë rast kur ndërmarrjet publike krijon nën pronësi edhe të nivelit qendror dhe lokal, pastaj vetëm shkaktohen probleme të mëtutjeshme. Unë e kuptoj se ky ndryshim është bërë për shkak të Trepçës edhe deri me tani të gjitha ndryshimet që propozohen, këtu nuk janë pjesë e këtij propozimi të Projektpropozimet, andaj është mirë që ndoshta ky Komision t’i adresoj edhe çështjet që u ngritën nga kolegët e mi të Shoqërisë Civile, që e para ka të bëjë me

përgjegjësinë financiare që kanë anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike, si ato në nivel qendror dhe lokal.

Ne e dimë se këto borde aktualisht janë vend punësime të partive politike, keq menaxhohen por ajo çka ndodhë se zyrtarët dhe anëtarët e mëhershëm të këtyre bordeve edhe kryeshfat ekzekutiv, e lëshojnë vendin e punës më të pasur se sa kanë qenë, ndërsa ndërmarrjet janë më të varfra, jofunksionale edhe shpeshherë me borxhe me vlera me miliona. Andaj, unë mendoj se ky komision është me rëndësi të adresoj edhe këtë përgjegjësi financiare për arsye se njerëzit që keq menaxhojnë me ndërmarrjet publike, duhet të përfundojnë në burg e jo më të pasur në shtëpitë e tyre.

Në anën tjetër, e kemi edhe një vërejtje sa i përket mënyrës se si është rregulluar raportimi për arsye se politika me ndërmarrjet lokale në këtë rast, ka dorë drejtpërdrejtë në emërtimin e aksionarëve, në këtë rast të anëtarëve të Bordit, por na mendojmë se duhet me e gjetur një formulë që më së paku i lejojmë politikës ndërhyrje, ndërsa profesionistëve u lëmë hapësirë që të jenë pjesë e këtyre ndërmarrjeve për arsye se ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës, jo vetëm në nivel lokal por qendror kanë nevojë për profesionalistë e jo për anëtarë të partive politike që e zënë vetëm një vend të punës e që ndoshta për fat të keq edhe janë të korruptuar. Andaj përpos rekomandimit të drejtpërdrejtë që neni 11.3 të ndryshohet dhe të dhe fjala: “marrëveshje” të shlyhet por të bëhet: “në konsultim me komunitat” konsultim ose pëlqim në këtë aspekt bëhet fjalë nëse komunitat mund të ftohen nëpër komisione punuese nëse ndërtohet, nëse themelohet ndonjë ndërmarrje publike në komunitat e tyre por assesi të lejohet fjala “marrëveshje” për arsye se kompetencat e nivelit qendror, janë të qartë me atyre të nivelit lokal në themelimin e ndërmarrjeve publike. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Edhe Komisioni ka diskutuar që të bëhen edhe intervenime edhe në pjesë tjera, në nenet tjera të Ligjit, ndërsa Qeveria i ka adresuar vetëm këto nene, por na kemi pasur në diskutim edhe me ministrin dhe ai është pajtuar. Mendoj se është pak një problem ligjor se a kemi të drejtë na me hyrë në nenet tjera dhe si duket nuk është shumë praktikë, por edhe nuk është e ndaluar. Mendoj se, meqenëse na kemi këtu një bashkëpunim edhe me propozuesin, besoj se do të

shikojmë se në të cilat pjesë të ligjit duhet të ketë një intervenim më të madh. Në mes tyre është edhe kjo sigurisht përgjegjësia e bordeve dhe kompetenca e tyre dhe llogaridhënia. Kjo është çështja kryesore që është diskutuar disa herë dhe është aktuale.

Vazhdojmë më tutje, zotëri Ibush Jonuzi,

IBUSH JONUZI: Faleminderit kryetar!

Përshëndetje të nderuar deputetë,

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,

E tha menaxheri profa Ahmet që edhe ju që e keni thënë në fillim të kësaj mbledhjeje parlamentare se e kemi përcjellë me përkushtim shqyrtimin e parë të këtij ligji dhe debatin në Parlament. Pika më e nxehtë ka qenë neni 13, pika 11.3 mos me e zgjatë, mendoj se duhet t'i shtohet, aty ku thotë: “regjistrimi si ndërmarrje publike bëhet në marrëveshje me komunat në territorin në të cilat gjenden ato ndërmarrje”, me iu shtua “përgjashtimisht ka të bëjë me ato ndërmarrje që janë me interes nacional”. Përndryshe ato që i tha edhe një herë po e them, profa Ahmet, plotësisht i mbështesë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, vazhdojmë më tutje. Fjalën e ka Nazmi Mikullovc.

NAZMI MIKULLOVCI:

Unë jam Nazmi Mikullovc, Unë pajtohem. Këtu pothuaj se të gjitha gjërat u thanë, unë vetëm kisha dashur edhe një me thënë kushtimisht me e thënë edhe në dilemë. U përmend çështja e borxheve, me propozimin e kaluar, ka qenë në definicion sipas meje i pranueshëm dhe i qartë, ka thënë: munden të barten vetëm ato borxhe të cilat vërtetohen nga një arbitrazh e pavarur ose nga një gjykatë. Dhe mendoj se çështja e borxheve disi në këtë propozim tash me hekë sepse ai ka mbet pezull edhe sa i përket Trepçës edhe sa i përket...

(Ndërhyrje)

... Po e di që rregullohen, por disa gjëra për shkak të një eksperience të keqe që kemi pasur me mujtë me e bërë një përkufizim, kishte qenë mirë edhe këtu tash kur po e bëjmë, por edhe te 11.3 për të cilin po flasim.

Çështja e dytë, pasi unë jam pak në moshë, e mbajë në mend që me ligjet e Kosovës të atëhershme prona publike nuk është shitur, ndërmarrjet e kanë marrë në shfrytëzim dhe është bërë nga AKM-ja dhe AKP-ja një keqinterpretim sepse pronën të cilën e kanë pasur në shfrytëzim dhe kanë paguar taksë për shfrytëzimin e saj, e kanë shitur, do me thënë kanë shitur diçka që nuk është e tyre, dhe unë mendoj në kuadër që, sigurisht që do të bëhet një rishikim i politikave të privatizimit dhe krejt, ta shfrytëzoj rastin këtu tash ta përmendi, që të shikohet kjo dhe disa gjëra të cilat kuptohet duhet me u kompensua ai i cili e ka blerë se tash nuk mundemi me i thënë atij ti mbajë pasojat pse ligji është interpretuar gabimisht, por disa gjëra pak më thjeshtë ishin rregulluar sa i përket edhe Ligjit 11, pikës në të cilën tash po donë me e rregulluar me pikën 11.3. Unë pajtohem me këtë që u tha deri me tash, sa i përket qartësisë, ndoshta për shkak se, me ju thënë të drejtën neve po na brengosin këto resurset natyrore të cilat deri në këtë mënyrë me u bërë problematike shfrytëzimi, ndoshta edhe në formulim me e thënë me e cekë se për ato, kjo pikë nuk vlen dhe atëherë kështu, se të gjithë jemi për atë që komunat janë zhveshë tërësisht gjatë këtij procesi për sa ndodhën 12 vjet,sa po zgjatë privatizimi, janë zhveshë prej pronës në tërësi.

Kjo është çështja e dytë që desha me e thënë dhe çështja e tretë, këtu për Trepçën kur po flasim, pajtohem me drejtorin çështja më problematike është tepër koha e gjatë, kjo po zgjatë prej vitit 2011, tash do të zgjatë deri në fund të vitit 2016. Është një gjendje pothuaj se me pasoja të papërmirësueshme edhe frika është që kur të përfundoj dhe i rregullojmë, qysh kanë thënë kur e mësojmë gomarin mos me hënger, ai ngordhë e është një rrezik për disa pasoja të cilat sot kishin qenë të panevojshme me i shpjeguar dhe arsyetuar, por të them që kjo disi për mua të paktën por nënkuptohet se statusi po thotë dhe riorganizimi i Trepçës do të rregullohet me strategji dhe ligj të veçantë dhe kjo po ndodhë, ky rregullim po ndodhë në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe atëherë unë e nxjerr një përfundim që do me thënë statusi është ndërmarrje publike, sepse na nuk kemi tjetër ose është privat ose është publike, janë format e ndryshme të ndërmarrjeve private,

por këto dy forma i kemi, nuk kemi të tretën. Nuk e di pse po hezitohet nëse është ajo zgjedhja që me u shkrua në këtë propozim, pa marrë parasysh që kishte qenë një prejdukim, e kam të qartë, por kishte formuar një qetësi të punës edhe në Trepçë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë më tutje me diskutime. A paraqitet edhe dikush tjetër? Urdhëroni, zoti Ramadan Sejdiu nga Njësia për monitorim të ndërmarrjeve publike.

RAMADAN SEJDIU: I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm të tjerë,

Unë më shumë do të përqendrohem në një njoftim sepse këtu u fol shumë rreth ndryshimeve të tjera edhe të çështjeve të ndryshmeve të ndërmarrjeve publike. Të gjithë e dini se Ligji bazik është, del nga paketa e Ahtisarit, ligj i miratuar në vitin 2008. Ky Ligj është ndryshuar nën presionin apo nën angazhimet që t'ju japim kompetencë më shumë komunave të ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe të raportimit edhe atëherë ka pasur kërkesa për ndryshime e të tjera. Ligji bazik ka shumë konfuzion, nuk e ka të sqaruar mirë llogaridhënien. Mandej, pavarësia shpeshherë keqkuptohet, një nen thotë duhet te ketë mbikëqyrje rigoroze, neni tjetër thotë alineja e mësipërme nuk bën të cenohet pavarësia, nuk bën të bëhet mbikëqyrja e kështu në atë formë. Dhe, duke keqpërdorur këtë shpeshherë po vijmë në situatë, kur ka edhe keqpërdorim të parasë publike.

E dimë se ky komision në Kuvendin e kaluar e ka shtjelluar raportimin. Ne kemi raportuar për zbatimin e Ligjit për ndërmarrje publike dhe ky komision, gjithashtu edhe Kuvendi ka dhënë rekomandimin për ndryshimin e ligjit. Rekomandimet prekin më shumë gjëra, më shumë sfera, sidomos ka të bëjë me ato që përmendi kolegu më përpara rreth raportimit të kënaqësisë së konsumatorëve, se tani për tani me këtë ligj ai raportim është subjektiv, sepse gjithkush e lavdëron vetveten. Realiteti nuk është ashtu.

Do të duhej të prek auditimin, do të duhej të prek rritjen e llogaridhënies, do të duhet të prek pavarësinë politike, sidomos të menaxhmentit, edhe të menaxhmentit, të bordit po se po, po edhe të menaxhmentit. Por, do të duhet të rregullojë edhe

shumë çështje të ndërmarrjeve publike lokale. Siç e dini kemi për çdo ditë probleme, sidomos te ato ku është bërë bashkëpronësia e disa komunave, mandej emërimi i bordit, përzgjedhja e menaxhmentit.

Ju e dini se ne e kemi edhe një rregullore për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale. Tani jemi në plotësim-ndryshim të asaj rregulloreje, sepse kemi shumë kërkesa të panumërta të komunave. Secila komunë t'i ketë nga dy-tri ndërmarrje publike lokale. Mu për atë do ta ndryshojmë dhe do të sqarohemi qartë, se nga cili sektor ndërmarrja publike mund të ketë, komuna mund të ketë ndërmarrje publike lokale, sepse janë disa sektorë, për shembull sektori i furnizimit të ujit, se është e pamundur.

Të gjitha këto ne i kemi menduar, meqenëse edhe ky ndryshim i ligjit po vjen si me më urgjencë, i kemi menduar se në moment që miratohet ky plotësim-ndryshim, ne të fillojmë hartimin e plotësim-ndryshimit apo, nëse ndryshon më shumë se 40% një ligj të ri, në të cilin do të involvojmë të gjithë aktorët, shoqërinë civile dhe ndërmarrjet publike, sepse shpeshherë bëjmë ligje nga tavolina dhe kur të vjen puna për implementim, atë është vështirë për ta implementuar.

Unë veç kam dërguar te stafi ligjor i të cilës të gjitha ndërmarrjeve publike që t'i dërgojnë mendimet se çka duhet të ndryshojë ligji dhe janë plotësisht të arsyeshme kërkesat e të tjerëve, se duhet të rregullohen e tjera... por, mendoj se në këtë moment, ndoshta edhe mundësia ligjore është e pamundur tash me e kthye, por edhe nëse e kthejmë kemi me e bë një ndryshim kozmetik dhe kanë me mbet shumë çështje pa u rregullua.

Mendoj se shumë shpejt duhet ta bëjmë një ligj të ri, sepse atje e dimë, i ka rekomandimet e Kuvendit, komisionet kanë qenë disa dhe një prej rekomandimeve ka qenë edhe ngritja e kapaciteteve të kësaj njësie, e cila e monitoron, që për afërsisht nuk ka kapacitetet e mjaftueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Sejtiu! Vazhdojmë tutje! A kemi diskutues të tjerë? Nëse, nuk ka diskutues të tjerë, zoti Visar Ymeri ka disa pyetje.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit shumë për kontributin, që po e jepni në diskutimin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Unë vetëm desha nga ato që u thanë, t'i shtoj mbase disa pyetje. Nuk mendoj se kam më shumë se dy pyetje të përmbledhura, natyrisht që i referohen disa prej diskutuesve e që janë drejtpërsëdrejti të lidhura me pikën, ose nenin 3, 11.3.

Në diskutimet që i kemi pasur në Kuvend, me sa i kam dëgjuar unë, e i kam dëgjuar goxha me vëmendje të gjithë deputetët, askush prej deputetëve nuk ka kërkuar që krejt këtë pikë me e fshi, se e di që shpeshherë është keqkuptuar që po thuhet që të fshihet pika 11.3. Jo. Vetëm një pjesë e pikës 11.3 ka qenë problematike, është pikërisht kjo që iu referuam, domethënë që ka të bëjë me kompetencat e komunës, që parashihen në këtë nen.

Edhe këtu po flasim për një situatë të veçantë. Pra, mendoj se duhet ta trajtojmë në këtë drejtim. Nuk po flasim as për pronën në tërësi e as për ndërmarrjet në tërësi e as për ndërmarrjet aktualisht që janë. Po flasim për një situatë të veçantë, kur Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim të Kuvendit vendosin, që një ndërmarrje shoqërore ta shndërrojnë në publike. Domethënë, në këtë moment vjen në spikamë kjo kompetenca e komunës, vetëm në këtë moment, sipas këtij ligji.

Pastaj, kjo ndërhyrja ose kompetenca që i kanë komunat nëpër rastet tjera janë të shpërndara gjithandej nëpër ligj, krijimin e ndërmarrjeve publike lokale është me këtë ligj, po me nenet tjera, se si e bën komuna. E kemi pastaj, te Ligjin për AKP-në, ku aty kërkohet një lloj konsultimi me komunat në raste të caktuara, po këtu po flasim për një rast të veçantë.

Dhe, mendoj që në këtë drejtim do të kisha dashur t'i pyes dy prej personave që ngritën këtë çështje. Zoti Demi nga GAP-i tha që ta ndryshojmë, sa e kuptova unë, formulimin. Pra, jo të themi ndërmarrje, po të themi pronë. Dhe në këtë rast, kjo nënkupton që kur një ndërmarrje shoqërore do ta shndërrojmë në ndërmarrje publike me vendim të Kuvendit, atëherë regjistrimi i pronës së kësaj ndërmarrjeje sikur pronë publike do të duhej të shkonte në marrëveshje me komunën, apo jo? Se, kur flasim për ndërmarrje flasim automatikisht edhe për pronën e ndërmarrjes. Ndërmarrja nuk ekziston jashtë pronës, veçanërisht me procesin e privatizimit në Kosovës, ku privatizimi i një ndërmarrjeje ka nënkuptuar privatizim të aseteve, pra të pronës e jo edhe të përgjegjësive e të borxheve.

Në këtë drejtim, në momentin kur themi pronë, atëherë e kemi lidhur me ndërmarrjen, me sa unë po kuptoj. Po, kisha pasur dëshirë që këtë të na sqaroni, si është propozimi juaj.

Edhe e dyta është që, këtu që u përmend nga asociacioni, me gjasë përfaqësuesi i asociacionit të komunave, që tha që me këtë përfitojnë komunitat. Natyrisht, që e marrin një ndikim shtesë, për sa u përket çështjeve të caktuara. Më falni, nëse gaboj atëherë më përmirëso! Unë kisha dashur të pyes, a është kjo vërtet duke i pasur parasysh të gjitha problemet që u përmendën e që janë përmendur edhe më herët, domethënë te çerdhja në Fushë Kosovë, e secila komunë ka problem me pronën, e cila i është tjetërsuar në njëfarë mënyre nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Po a mendoni që kjo është mënyra më e mirë, për ta zgjidhur këtë çështje e cila, mos më keqkuptoni, por në njëfarë mënyre në logjikën e të arsyetuarit po e ngërthen në vete njëllë antagonizmi të përhershëm në mes nivelit qendror dhe lokal, ku ka antagonizëm në interesa, ku niveli qendror me vendimet e veta e dëmton, se s'bën atë interesin lokal dhe rrjedhimisht duhet me ia lënë një kompetencë interesave, domethënë, qeverive lokale, në mënyrë që me e mbrojt interesin e vet lokal.

Unë nuk mendoj që kjo është kështu. Natyrisht, që karshi disa çështjeve politike, partive politike, e kështu me radhë, që kanë qeverisur deri më tash, ka pasur edhe raste të tilla. Unë mendoj që komuna deri tash të paktën, e kanë pasur problemin kryesor që e kanë pasur me pronën, kanë pasur të dy llojet: një, pronën që e ka menaxhuar Agjencia Kosovare e Privatizimit; dhe në anën tjetër pastaj keqpërdorimin e pronës që është bërë nga vetë pushteti lokal, natyrisht në bashkëpunim me pushtetin qendror. Po, këto janë devijime nga standardi formal. Dhe, tash ne po duam ta formalizojmë, domethënë një mënyrë se si po pretendojmë ta zhdukim këtë problem, kur nuk mendoj që këtu është problemi.

Problemet që krijohen me një formulim të tillë janë të mëdha, sepse pastaj përnjëmend, nëse komuna do ta ketë vendimin përfundimtar në shndërrimin e një prone nga shoqërore në publike, atëherë kjo bëhet pengesë për nivelin qendror. Dhe këtu, mos të harrojmë, ne po flasim këtu, ndoshta jam dakord që varësisht se si do të përpilohet ky ligji i veçantë për "Trepçën", ky nen ose kjo mënyrë e të rregulluarit të kësaj çështjeje, do ta prekë ose jo "Trepçën". Nuk po dua të hyj andej. Këtë e kemi diskutuar disa herë.

Por, nuk po flasim vetëm për "Trepçën". Pra, nëse ne e bëjmë, ta zëmë, që prona shoqërore e cila do të duhej të shndërrohej në pronë publike, nuk bëhet pa komunën, atëherë duhet ta kemi parasysh tërë pronën shoqërore, që ekziston sot në

Kosovë, qoftë e organizuar si ndërmarrje ose jo, e cila futet pastaj rirregullohet me këtë nen. Pra, po flasim për Brezovicën, për... ku ta di unë, ndërmarrjet e ndryshme, që janë shoqërore ende të paprivatizuara, për pronën e tyre dhe kompetencat që ato i ngërthejnë.

Pra, nëse kjo lehet kështu, nëse kjo kompetencë lehet kështu, atëherë vendimin përfundimtar për Brezovicën, për këtë projekt koncesionimi, i cili është skandaloz më vete, por sidoqoftë, do ta ketë komuna e Shtërpces e jo vetëm e nivelit qendror. Pra, ta kemi parasysh edhe këtë. Të paktën unë e lexoj kështu, mbase e kam gabim. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, është e qartë kjo, po ne e kemi sqaruar këtë. Kjo duhet të ndryshohet. Kjo do të ndryshohet, domethënë ne s'kemi këtu dilema, s'kemi çka bindemi. Për ata kemi diskutuar. Zotëri Fatmir Rexhepi. Ju kisha lutur anëtarë të komisionit, ne do të kemi kohë për ta diskutuar, për t'i lexuar stenogramet, për t'i formuluar amendamentet... Diçka që mund ta provokojë diskutimin është e mirëseardhur, por jo ndoshta tash të fillojmë ne të shfaqim... S'besoj që edhe kemi shumë dilema në këto gjëra, as shumë dallime të mëdha. Faleminderit, pra...

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit për fjalën! Por, unë besoj që meqenëse është debati me të gjithë të pranishmit këtu, të cilët i prezantuan ju, të kemi edhe nja dy-tre mendime tonat, sepse në fund duhet kurorëzuar me amendamente konkrete, jemi pjesë e saj dhe normalisht, që ky debat me ndryshime në fund do të vijë deri te amendamentimet.

Unë e shoh me shumë interes gjithë ato sugjerime, që i thanë kolegët këtu nga përvoja e vet, nga eksperiencia e vetë, qoftë ata që vijnë nga industria me vite të tëra në eksperiencë, qoftë nga kolegët tjerë nga instituti që kanë këtu. Dhe, besoj që nuk jemi larg atyre ideve, se çka e si duhet të ndërtohen këto ndryshime, në kuadër të këtij Projektligji.

Unë po i bashkëngjitëm vetëm tri çështjeve, që u shtruan këtu. Por, mesazhi kryesor, që duhet të dalë nga çdo debat, qoftë që ishte në Parlament, qoftë ai që do të vijë më vonë, qoftë edhe ky debat, do të ishte se ne jemi përcaktuar për ekonomi të tregut dhe, në asnjë kohë nuk duhet kuptuar këtë korrigjim, këtë ndryshim, të marrjes së këtyre aseteve, të kësaj prone, e cila ka ndodhur dhe do të kthehet në

menaxhimin e Qeverisë, si një lloj etatizimi, pra krijimi i ndërmarrjeve shtetërore e tjera, e tjera...

Do të ishte keq, një mesazh jo i mirë, që nuk e ka këtë qëllim, por e ka qëllimin pra, që të marrim asete të ndërmarrjeve shoqërore, me qëllim, siç u tha këtu, të interesit publik, qoftë komunal, qoftë atyre nacional dhe ato t'i transformojmë dhe t'i kthejmë ose t'i përkthejmë në interes në zhvillim, në investime, në ndërtim, e kështu me radhë... Prandaj, ky do të ishte ai mesazhi, që desha ta cek.

Tjetra, është ajo që u tha për ndërmarrjet. Unë pajtohem plotësisht, që të ndryshohet ai nen për të cilin është bërë shumë fjalë, shumë debate, qoftë këtu, qoftë tjetërkund dhe, assesi të mos përfshihen ato ndërmarrje me interes nacional, në kuadër të asaj që e përmendën kolegët këtu. Prandaj, do ta formojmë, do ta ndryshojmë dhe do t'i ndajmë, pra listën e ndërmarrjeve nacionale dhe listën e ndërmarrjeve komunale, për të cilat komunat do të konsultohen dhe do të jenë pjesë e atyre ndryshimeve.

Tek “Trepça”, për të cilën me të drejtë njerëzit kanë ngritur, qoftë minatorët, qoftë kolegët që udhëheqin atje, telashet dhe problemet e tjera, që i kemi dëgjuar, aty duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Këtë kohë që e kemi, ta shfrytëzojmë për ta ndërtuar ashtu si duhet.

Pra, u bë mirë që u ndalua likuidimi i saj, duhet ta themi të gjithë bashkërisht. E patëm disa pasoja, i patëm disa trendë jo të mirë, por tash ja ku jemi bashkë sërish. Pra, ta gjejmë zgjidhjen më të mirë.

Paralelisht, pra të provojmë brenda këtij viti, me kryetarin, me ministrinë, me të gjithë kolegët deputetë këtu që jemi dhe, le të bëhet pra, Ligji për “Trepçën”, po besa edhe Strategjia për “Trepçën”. Dhe, Strategjia le të na tregojë neve, strategjia le të na tregojë a duhet “Trepça” të jetë ndërmarrje publike apo duhet “Trepça” të jetë ndonjë kompani e organizuar ndryshe.

Në bazë të asaj ne të vendosim nesër e ta fusim pastaj, që në kuadër të projektligjit që e aprovojmë edhe ta fusim, do të thotë, organizimin e “Trepçës”. Këtë duhet të lëmë, pra me kohë, por jo të zvarritet aq shumë, sikurse është zvarritur e të humbim kohë. Pra, kjo është ajo çka desha të cek.

Dhe në fund, normalisht, nëse ka vend, nëse ka mundësi që u përmend, me të vërtet bordet, menaxhimi, performanca, llogaridhënia e shumë gjëra të tjera... e kemi një

përvojë jo të mirë. Hajde ta ndalim, ta fusim në kuadër të këtij projekt-ligji dhe t'i japim fund. Dhe, të shohim si po menaxhohen, si po ecin tutje. Të japim llogari për çdo gjashtë muaj, për çdo vit. Me këtë pasuri, me këtë ndërmarrje secili prej nesh, cilido kuadër që vendoset aty, të mësohemi pra, të japim llogari për punën që e bëjmë. Na bën nder shoqëria kur na zgjedh deputet, na bën nder shoqëria ose institucione kur na zgjedh edhe kryetar të Bordit, në borde. Atëherë, si po ia kthejmë? Jo, ashtu siç thanë ata shokët, me dalë ashtu të pasuruar është marre, është turp për secilin prej nesh.

Prandaj, ta vendosim në projektligj dhe të punojmë mbarë e mirë! Kaq, kryetar! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, deputet Rexhepi!

Këtu u tha për këtë çështjen e kohës. Natyrisht, që në bazë të ligjit që e aprovoi Kuvendi më 19 janar, ndalohet çfarëdo procedure kundrejt "Trepçës" për 18 muaj dhe kjo i bie diku në nëntor... a ku ishte... në nëntor 2016. Mirëpo, kurrkush s'duhet ta kuptojë që deri atëherë ne do të... që atëherë duhet të vijë ligji.

Ne presim që ligji të vijë sivjet, të vijë në një kohë të arsyeshme. Ne do të shohim a kemi mundësi ta definojmë gjatë nxjerrjes së ligjit, por ajo që ne presim si komision, është që shtatori s'bën të na zërë pa këtë ligj, tash unë po e them shumë qartë, edhe pa këtë Strategji, ajo që ne presim. Po tash, do ta shohim, sepse ne duhet rreth "Trepçës" sigurisht do të ketë debate rreth zhvillimit të "Trepçës", jo pronësisë së "Trepçës", jo e kujt është "Trepça", se kjo na u bë një temë e imponuar, me të cilën u morëm me emocione dhe me konfrontime politike.

Thash, atë çështje e kemi tejkualuar, besoj! Tash është në rend dite "Trepça", si një problem zhvillimor i cili duhet t'i kontribuojë zhvillimit të Kosovës. Kjo është çështja jonë dhe është paraqitur.

Të lutem, Sazan, një sqarim në qoftë se, ke? Po, mandej është paraqitur deputetja Sala Berisha dhe deputeti...

SAZAN IBRAHIMI: Kryetar, unë vetëm shkurt. Është keqkuptuar ajo që e thash. Unë në asnjë mënyrë, kur është problemi apo çështja e interesit nacional apo kombëtar, që niveli lokal ta ketë atë mundësinë që t'i ndalojë disa procese. Domethënë, kjo ne jemi kundër kësaj. Jemi në atë kuptimin, kur AKP-ja ka bërë dhe ndonjëherë bën privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, ku komunat kanë

interes të një parcele me interes publik, atëherë bëhet që të negociohen, por jo në atë kuptimin që të ketë influencë në interesat kombëtare apo nacionale.

KRYETARI: Po, po, faleminderit! U sqarua! Edhe një...

(Ndërprerje e incizimit.)

Më falni! Neni 7 flet për përgjegjësinë e bordeve. Ju lutem, ta shikojmë në mënyrë precize se çka duhet të ndryshohet dhe sa duhet të ndryshohet, sepse nganjëherë nga moszbatimi i ligjeve, ne mendojmë se ligjet kanë faj. Po, unë e kam parë që ai nen është bukur i qartë për përgjegjësinë e bordeve të ndërmarrjeve publike.

Prandaj, ju lutem, ta shikojmë atë nen. Çka ka nevojë të precizohet, ne jemi të hapur për ta precizuar.

Vazhdojmë! Zonja Sala Berisha – Shala, deputeti Pal Lekaj, Raif Çela dhe Agron Demi për së dyti.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit në këtë dëgjim publik, pa dashur të humb kohë duke i përmendur me emër. Me shumicën prej tyre njihemi edhe më herët. Kemi bashkëpunuar në të kaluarën, qoftë si deputetë të të njëjtit komision, siç është zoti Ibushi apo edhe me të tjerët.

Dhe, qëllimi i dëgjimit publik është më shumë ne si deputetë të ju dëgjojmë juve, që vini prej anash, e që jeni më indiferentë, pa anime, jashtë kësaj. Dhe, për ata nuk duhet të humbim edhe shumë kohë. Por sidoqoftë, është mirë dhe qëllimi i dëgjimit publik është që t'i ftojme të gjithë ata aktorë, që nuk kanë mundësi të bëjnë draft-ligje përmes Qeverisë ose përmes Kuvendit, po që s'kanë mundësi të japin mendimet e veta ndryshe, ky edhe është qëllimi i dëgjimit publik.

Unë këtu po shoh shumicën prej jush, po ndoshta ka qenë dashur me qenë edhe ata ekspertë, që i përmendi kryetari, që i ka pasur në takim individual dhe t'i dëgjojmë kështu drejtpërsëdrejti ne si deputetë. Ne mund të japim ato opinionet tona, po flas personalisht, meqenëse unë vi nga “backgroundi” im profesional si inxhinierë, mund të them diçka se çka mund të jetë mirë, e çka s'mund të jetë. Por, konotacionet juridike mund të mos ia qëlloj, që është krejt normale.

Tani personalisht, unë kam menduar që ky ligj duhet t'i kthehet Qeverisë. Pse kam menduar që t'i kthehet Qeverisë? Sepse, më 19 janar me procedurë të shpejt u miratua Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve publike, që të mos e zgjas emrin më tutje, dhe në njëfarë forme i dhamë hapësirë, që "Trepça" të mos rrezikohet. Kështu që, ky është dashur t'i kthehet Qeverisë dhe të analizojë mirë Qeveria edhe nenet tjera, të cilat duhet t'i nënshtrohen plotësim-ndryshimit, siç e përmendi edhe përfaqësuesi i njësisë, që vjen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Pastaj, ju e dini që monitorimi i këtij ligji është bërë diku, nëse s'gaboj, në vitin 2013, e përmendët edhe ju. Rekomandimet e atij ligji nuk kanë reflektuar në këtë plotësim-ndryshim. Është edhe kjo njëra prej arsyeve, që është dashur t'i kthehet Qeverisë dhe është dashur ta kemi parasysh, ani pse mund të jetë një justifikim, se ka ardhur me procedurë të shpejtë, po 2013-a e sot jemi në vitin 2015... nuk arsyetohet as ajo.

Ne kemi, sa i përket shqetësimit të të gjithëve, jo vetëm juve këtu, po edhe të tjerëve edhe në Parlament atë ditë, kur është debatuar gjatë për plotësim ndryshimin e këtij ligji, shqetësimi kryesor ka qenë te neni 3, përkatësisht që ka të bëjë me nenin 11.3, pika e famshme, që unë mendoj se ndoshta kemi shpenzuar pak a shumë energji jo edhe aq sa duhet, sepse Ligji për miniera dhe minerale e përcakton shumë mirë, decidivisht, se nën 60 cm çdo pasuri është pasuri e Kosovës dhe ky mendoj që është një ligj që do t'i mbizotërojë edhe ligjet tjera.

U paraqit shqetësimi këtu, se kemi mundësi që me atë pasusin te 11.3-shi mund ta rrezikojmë pasurinë dhe mund ta rrezikojmë në të njëjtën kohë edhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, që resurset minerale janë shumë kokëforta dhe nuk njohin kufij administrativë, shtrihen në dy – tri komuna dhe për ata, sigurisht që te Ligji për miniera është paraparë edhe kjo dhe pa marrë parasysh a është pronë publike komunale a është pronë private, që prona private është shumë e shenjtë.

Kjo është e rregulluar me ligj, se nën 60 cm. Çdo pasuri, është pasuri e Kosovës, prandaj duhet ta kemi këtë shumë parasysh. Dhe tjetër për mua, po edhe për ju, është një lajm shumë i mirë se dhe Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme veç e nxori vendimin. Do të thotë, është në zbatim të ligjit që e miratuam më herët, kështu që unë mendoj që është e paarsyeshme që këtë ta çojmë në procedurë të shpejtë plotësim-ndryshimin e këtij ligji...

(Ndërhyrje: S'është procedurë e shpejtuar, por të rregullt është.)

Të rregullt por në qoftë se ky arrin ta ndryshojmë me mbi 40% do të thotë i bie se do të bëjmë një ligj të ri.

Tjetër! Meqenëse unë jam pjesë e Grupit punues, mendoj që bashkërisht me ju, edhe në të ardhmen, gjatë kohës si grup punues do të jemi në kontakt me ju, por sot prej jush kërkojmë që të gjitha këto vërejtje e sugjerime që i dhatë m e na i dërguar me shkrim, në formë të amendamentit, nëse keni mundësi dhe ne do të jemi këtu bashkë që ta bëjmë më të mirën të mundshme.

Një tjetër gjë, që prita, përveç këtij neni të famshëm, e ndoshta do ta përmend ndokush, unë personalisht mendoj që te bordet e ndërmarrjeve publike duhet të futet edhe kuota gjinore, të respektohet ligji për barazinë gjinore që është 40%, dhe deri tash nuk është respektuar askund. Sot do ta kemi mbështetjen e kolegëve të mi, e të shohim. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni!

PAL LEKAJ: Faleminderit kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Zonja dhe zotërinj,

Nuk pajtohem që ne nuk duhet të diskutojmë, edhe nga ana e juaj, por edhe nga ana e deputetëve. Këtu jemi të shprehim mendime, qofshin edhe të kundërta por të mos e bëjmë atë që është në Kosovë, se ne jemi të thirrur të dëgjojmë por asnjëherë t'i pranojmë ato mendime ndryshe. Dhe, unë jam ithtar që edhe mendimet ndryshe të merren në atë prizmen e një zhvillimi, të një procesi pozitiv.

Ajo që desha të diskutoj me ju, është pse mendoni që me nenin 3 pika 11.3 të përmenden komunat dhe të krijohen dy themelues të një ndërmarrjeje publike – qeveria dhe komuna. Ne jemi pajtuar që pasusi i fundit i kësaj pike 11.3 ku thuhet se ndërmarrjet shoqërore mund të shndërrohen në ndërmarrje publike me marrëveshje me komunat, ky pasus të hiqet krejt, por jo krejt neni sepse atëherë s'ka kuptim as plotësim-ndryshimi i ligjit.

Pse e them këtë? Ekziston Ligji për ndërmarrjet komunale, që e sanksionon qartë e mirë të drejtën e komunës, ekziston Ligji mbi pronën dhe shpronësimin që prapë e sanksionon drejt dhe mirë. Pajtoj me kryetarin që edhe për bordet, neni 7, ku precizohet se nuk kanë të drejtë ata që janë aktivë në politikë, që janë anëtarë të

kryesive së paku pesë vite. Mirëpo, a ka ndodhë kjo që janë keqpërdorë? Po ju them, po!

Po e marr vetëm ndërmarrjen komunale publike, që janë aksionarë komunitat 100%. Aty shkon trup, dhe vetë kam qenë, shkon trup politike dhe jo profesionale. Prandaj, unë këtu po du ta diskutoj me ju, pse duhet me u përmend, pse të mos shlyhet komplet komuna. Dhe në këtë drejtim ta sqarojmë njëherë e përgjithmonë. Pse po i ngatërrojmë? Të konsultohet pastaj, jo të veprojë, jo të hiqet kjo, të amendamentohet që për afërsisht gati jemi pajtuar me disa ndryshime e mendime të ndryshme, në nuanca të mos them, por nuk shkojnë në kundërshtim me atë që ne po domë ta bëjmë.

Ekziston edhe ajo që dua të diskutoj me ju. Nëse Agjencioni Kosovar i Privatizimit merret me pronat shoqërore dhe tani hiqet krejt, çka ka nevojë Agjencioni Kosovar i Privatizimit të ekzistojë?

Do të thotë, duhet ne të mendojmë edhe për këtë çështje që edhe ai të thotë – rruga e mbarë!

E përmendi dikush, që ka plotësisht të drejtë, ish drejtori i Trepçës, që kam respekt, për pronat komunale që janë dhënë në shfrytëzim. Kemi pasur në Gjakovë, kemi dhënë në shfrytëzim kooperativa bujqësore dhe ata, ai që e ka dhënë në shfrytëzim ka të drejtë ta abrogojë atë vendim dhe t'i kthehet pronës komunale, që e kemi marrë një vendim në Gjakovë. Mirëpo, krejt j anë çua për interesa të ndryshme individuale dhe na kanë kritikuar.

Do të thotë, janë këto që po dua t'i diskutoj me ju, së bashku me të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni ju tjetri!

RAIF QELA: Unë do të bëj përpjekje që të jam sa më preciz. Në këtë dëgjim publik për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, pikërisht se për shkak që përmes tij fillimisht u synua që të pengohet likuidimi i paralajmëruar i Kombinatit “Trepça” prandaj këtu jemi edhe ta shqyrtojmë këtë çështje.

Pikërisht se ky ishte njëfarë hapi i domosdoshëm që përmes njërit prej këtyre projektligjeve të bëhet pengimi i rrezikimit të likuidimit të Trepçës, arsyetohej

propozimi i tillë nga ana e Qeverisë. Mirëpo, si po e shohim edhe nga parafolësit, vetëm për shkak të politizimit të çështjes së Trepçës, ky projektligj e ka pas arsyetimin pse ka dalë.

Në përmbajtje ky projektligj, që e kemi sot në shqyrtim nuk do të kishte nevojë të procedohej me këtë nguti apo nuk do të kishte nevojë të procedohej fare, sepse tashmë qëllimi për të cilin ky u iniciua fillimisht, evitimi i rrezikut të likuidimit të Ndërmarrjes “Trepça” u realizua përmes një ligji tjetër – Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara.

Mirëpo, përmbajtja e këtij projektligji që po e shqyrtojmë sot, sikur që e thanë edhe një mori e parafolësve, nuk bën ndonjë plotësim me rëndësi kapitale në fushën e vet. Kjo është e vërteta. Dhe, për deri sa është kështu, vetëm për shkak se me një nen të tillë e detyron nxjerrjen e një strategjie apo ligji të veçantë për Kombinatin “Trepça” dhe për këtë arsye mund të vazhdojë në procedim, meqenëse ka shkuar si ka shkuar se përndryshe nuk e arsyeton.

Lidhur me paragrafin 11 pika 3, të ligjit që llogaritet të bëhet shtesë e ligjit bazik, në këtë komision kemi qenë unik që të gjithë që në mënyrë të mos ketë hapësirë për manipulime të mëvonshme, këtë nen ose duhet t’ia heqim pasusin e dytë ose duhet që ai të ndryshohet në atë mënyrë që komunat të mos kenë mundësi të bëhen pengesë për interesat madhore të pushtetit qendror.

Konkretisht, në vend të tekstit, në marrëveshje me komunat, nëse duhet patjetër të ekzistojë pjesa kur përmenden edhe komunat, të jetë ndonjë formulim jo detyrues për pushtetin qendror në raport me atë lokal.

Komunat mund të gëzojnë të drejtën në raport me ndërmarrjet publike, me karakter lokal, por për ndërmarrjet publike qendrore me rëndësi të veçantë, ato mund të kenë kompetenca të caktuara vetëm sa i përket interesit publik në fushën e infrastrukturës, të shëndetësisë, të punësimit, të arsimit e tjera dhe nuk duhet tu mundësohet që komunat të bëhen pengesë për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Meqenëse ne si komision edhe kemi qenë unikë për këtë, besoj se do të jetë një formulim shumë preciz e të mos ketë mundësi për manipulime të mëvonshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Agron Demi e ka fjalën!

AGRON DEMI: Faleminderit! Është shumë shkurtër, për atë që e përmendi zoti Ymeri dhe mos e merrni si vërejtje por shqetësimi im është që kërkohet shpesh të paraqitet një rekomandim apo një shqetësim të shoqërisë civile ose grupeve jashtë parlamentare në formë të amendamentit. Ajo ishte dashtë me qenë pjesë e komisionit për shkak se, nëse i kërkohet edhe grupeve të interesit me e prurë në formë të amendamentit, kjo veç e prishë strukturën e ligjit.

(Ndëhyrje)

Po ajo që desha me e ngrit, dhe pajtohem me Sazanin për shkak se komunat e shohin se e kanë një pronë para objektit të tyre dhe nuk kanë asnjë kompetencë as për të ndreqë çerdhe apo objekt administrativ dhe unë kërkova që të konsultohen komunat para se të privatizohen dhe me pas mundësi aty të ndërtohet diçka, që është shumë më lirë se sa me e ble prej pronës private.

Ky ishte rekomandimi im. Dhe ajo qysh do të interpretohet në nen dhe si do të duket, është pjesë e Komisionit.

Edhe te neni 7 i bordeve. Edhe na u lexua shumë qartë se bordit ishte dashur t'i jepet përgjegjësi, por për shembull njësia për monitorim shumë mirë e ka monitoruar dhe ka dhënë vërejtjet negative për Bordin e PTK-së, dhe po del që Qeveria ato vërejtje negative të vetë njësisë nuk i merr parasysh por e zgjedh të njëjtin kryesues të Bordit të PTK-së dhe tani na lind problemi sikur ai i javës së kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, është problemi te zbatimi? Dhe, tash Kuvendi duhet ta luaj rolin e vet. Urdhëroni edhe ju Dardan... apo?

AVNI BYTYQI: Po, Avni Bytyqi jam! S'prish punë!

KRYETARI: Dardan Abazi, a je ti?

AVNI BYTYQI: Jo, unë jam Avni Bytyqi! Unë e kam vetëm një koment. Kryetar, pra, e kam një koment, në formë të vërejtjes për arsye se ky është drafti i tretë për këtë çështje. Në draftin e parë fjala "marrëveshje" nuk mund të ekzistojë fare, për shkak të implikimeve pastaj politike dhe të grupeve të komuniteteve, që e dimë si kanë rrjedhë, kanë dalë. Mirëpo, ajo që po më shqetëson është se në mesin e të gjithë kolegëve këtu, të gjithë po pajtohemi se fjala "marrëveshje" duhet të largohet. Shpresoj se drafti i fundit që do të dalë pas këtij takimi, me të vërtetë...

(Ndërhyrje)

Po, vetëm fjala “marrëveshje” në këtë rast dhe arsyen pse ne kemi propozuar të jenë, për shembull, të konsultohet me komunat për arsye se fjala “konsultim” nuk nënkupton se e bën atë faktor, për arsye se ... e informon, shkon në një takim, e bën pjesë të grupit punues, por unë e kam fjalën e fundit në “themelim”. Arsye pse ne e kemi punuar fjalën “konstatuese” është se Kosova në Kushtetutën e saj e ka edhe parimin e subsidialitetit, që është parim bazë i qeverisjes lokale dhe si rregull i qeverisjes lokale, që bie në përputhshmëri me standardin e Bashkimit Evropian. Pastaj edhe Qeveria e Kosovës e ka aprovuar një udhëzues nga Këshilli i Evropës për udhëzimin e konsultimeve publike me qytetarët ku aty shihet niveli i konsultimit, nuk është në nivelin e bashkëvendimarrjes, është e definuar dhe e sqaruar shumë qartë.

Andaj, ju lus në emër të Institutit që sot e përfaqësoj por edhe nga ne të gjithë këtu unanimisht po pajtohem se fjala “marrëveshje” të largohet nga ky nen, për arsye se e faktorizon komunën në atë masë, dhe për arsye se ne të gjithë po pajtohem se pasuritë nuk janë vetëm të atyre qytetarëve, të atyre komunave, por janë të gjithë qytetarëve dhe ne mendojmë se konsultimi është termi më adekuat për arsye edhe ata qytetarë që jetojnë në ato zona sigurisht se do të ndikohen, do të ketë ndryshime në strukturën e jetës së tyre, pastaj ju kisha lutur që të merren parasysh.

Ndërsa sa i përket zonjës Shala, kur përmendi te puna e shkrimit, Instituti ynë së bashku me Institutin GAP – komisionit paraparak ia ka dërguar me shkrim, e në këtë rast Institutit GAP përsëri ia ka dërguar me shkrim dhe ne vazhdimisht i adresohemi, mirëpo për fat të keq të jemi më të sinqertë, ne nuk po shohim ndryshimet në drafte për arsye se unë i kam të tre draften, dhe shpresoj draftin e katërt kur e dërgoni fjalën “marrëveshje” më nuk do ta shohim. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, preferohet mos të flisni nga dy herë, sepse ne jemi këtu në dëgjim publik dhe pastaj ne në mes veti kemi kohë të flasim prapë.

ENVER HOTI: Faleminderit kryetar!

Është një pajtueshmëri e gjerë dhe është mirë që është edhe për nenin 11 paragrafi 3. Me u formulua edhe një herë, dhe nuk shohim ndonjë arsye që të ketë vonesa në procedimin e mëtutjeshëm për çështje tjera, sepse qëllimi kryesor edhe në debat edhe në Kuvend ka qenë ky neni 11 pikë 3 dhe s’ shohim ndonjë arsye.

Natyrisht, thirrjen tuaj e mbështes plotësisht kryetar lidhur me kohën për menaxhim lidhur me hartimin e strategjisë për Trepçën, për të dalë nga situata aktuale.

Ishin edhe shqetësimet e drejtorit të menaxhmentit dhe të shfrytëzohen të gjitha ekspertizat e aktorëve që të mund të japin kontribut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni ju, tjetri!

MIFTAR HYSENI: Faleminderit!

Unë jam Miftar Hyseni, zëvendës-menaxher i Trepçës para disa ditësh. Për Trepçën thanë çka deshën me thënë dhe si e dëgjova, zotëri deputeti, pati me thënë këtë, kur e kërkoja fjalën, por megjithatë po i përsëris ndoshta ato fjalë që i tha deputeti, të cilit emrin ia harrova.

Ju thatë se deri kah shtatori do të bëhet diçka për Trepçën...

(Ndërhyrje)

Në atë drejtim, unë e kisha pas një kërkesë dhe ju lutem, bëni atë çka mundeni, çka keni në plan me bë deri në fund të qershorit dhe na e lehtësoni punën për vazhdimin e prodhimit në Trepçë, përndryshe nëse e bëni kah fundi i shtatorit kemi me pas telashe. Vetëm kaq desha të them! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do ta përcjellim këtë! Urdhëroni, kolege!

SALA BERISHA-SHALA: Më duket se ma përmendi mbiemrin tim ky Avni Bytyqi, mu dukte ishte.

Dëgjoni, është shumë e vërtetë dhe është për ta falënderuar GAP-in dhe INDEP-in dhe të gjithë shoqëritë civile të cilat kanë punuar shumë në këtë drejtim dhe kanë punuar edhe për këtë ligj po edhe ligje tjera, që kanë qenë në favor të komisionit tonë, mirëpo sa janë inkorporuar në drafte e ligje, aty vendoset me votë, me fuqi të votës e nganjëherë nuk do të thotë se vota ia qëllon. Shpesh nuk ia qëllon!

Mua më vjen shumë mirë që ju kemi këtu dhe kemi këtu ish menaxher të Trepçës e menaxher të tashëm, por pse s'i keni thirrur të gjithë ish menaxherët e Trepçës e ndoshta kanë pas me na thënë diçka, që s'patëm rastin me dëgjua prej juve.

(Ndërhyrje)

Dhe tjetra! Kryetar unë këtë e prita, desha pak ta relaksoj situatën. Sigurisht që i kanë përfaqësuesit e vet këtu, por sigurisht edhe përfaqësuesit e vet i ka edhe Vetëvendosja këtu, se zoti Mukullovc i është eksponent politik i Vetëvendosjes, por sidoqoftë e vlerësojmë shumë edhe ekspertizën e tij.

(Ndërhyrje)

Jo, këtu s'ka kurrfarë faji! Për sa janë më të mirë, mbetet koha t'i vlerësojmë, por këtu përnjëmend me të drejtë u përmend këtu që bordet duhet të jenë të depolitizuar por në ndërkohë deri sa u fliste për bordet e depolitizuara dhe mua më shkoj mendja a thua a jemi ne në rrezik më të madh prej ekspertëve të politizuar politikë apo prej udhëheqësve të bordeve politike, kështu që nuk mundemi shumë me bë zhurmë rreth kësaj fjale, sepse këtu keni mundësi për një rreth vicioz, ekspertat politikë, bordet politike dhe shqyr që i kemi, e inshallah veç janë ekspertë e ia qëllonjë.

Dhe, mua që po më pengon, sinqerisht po them, ajo që po më pengon shumë – kohëve të fundit po më duket se më shumë po bëjmë fjalë se punë. Uroj që t'i kthehemi të kundërtës, të bëjmë më shumë punë se sa fjalë. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Përndryshe, këtu dilema ishte a me u heq pika 3. Unë e di që shumë komuna kanë telashe dhe ne vetëm duhet ta formulojmë mirë. Komuna e Prishtinës ka telashe me Pallatin e Sporteve dhe të Rinisë, disa komuna kanë me kinema, kanë telashe disa komuna me tokë komunale, por ne duhet të gjejmë formulimin që mundëson.

Tani po thoni, dhe unë e dëgjova në diskutim që komunat edhe me ligjin kanë të drejtë të fitojnë ndërmarrje publike. Me ligjin ekzistues! Sigurisht, kurrkush s'ua ndalë, por s'kanë t'i marrin ato prona që sot janë te Agjencia e Privatizimit, e ne po ua mundësojmë që pronat që janë në Agjenci të Privatizimit, ato me i shfrytëzuar për interes publik.

(Ndërhyrje)

Po, normal o Visar! Aty bile unë e ti, e kemi të qartë. Dhe e kemi analizuar në atë kohë. Domethënë, është problemi sot, se për shembull komuna e Prishtinës s'mund kurrjë të bëjë me Pallatin e Rinisë. A mundet të bëjë diçka? Jo, sepse është në Agjenci të Privatizimit. Këtë problem ne duhet ta zgjidhim, dhe ky është një problem urgjent, por nuk është problem dhe të zgjidhet për tri ditë, por që sa më shpejt ta zgjedhim është më mirë.

Ju faleminderit!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë